



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-023
Prishtinë, më 22 maj 2015, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 22 MAJ 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Aida Dërguti dhe Slobodan Petroviq, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Glauk Konjufca, Pal Lekaj, Valdete Bajrami dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Uran Ismaili;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe disa përfaqësues të organizatave dhe të Shoqërisë Civile dhe të tjerë, që i përcjellin punimet e Kuvendit.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Konfirmimi i rendit të ditës për seancë plenare,
2. Përgatitjet për seancën plenare tjetër të radhës.

1. Konfirmimi i rendit të ditës për seancë plenare

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me përgatitjet për seancën e radhës, mbështetur në vendimin e seancës plenare, datë 18 maj 2015, konfirmoi që seanca plenare e radhës të mbahet më 28 maj 2015, në orën 10:00, me këtë rend dite:

Rend dite

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Avokatin e Popullit,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit kundër diskriminimit,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për barazi gjinore,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përgjimin e telekomunikimeve,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kompensimin e viktimave të krimit.
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

2. Përgatitjet për seancën plenare tjetër të radhës

Kryetari i Kuvendit i njoftoi anëtarët e Kryesisë me dy (2) pika, të cilat mund të shqyrtohen në seancë plenare, gjatë ditëve në vijim, dhe atë:

1. Shqyrtimi i propozim-amendamentit nr. 24 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe
2. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit të Posaçëm për zgjedhjen e dy (2) gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Lidhur me pikën e propozuar të rendit të ditës - Shqyrtimi i propozim-amendamentit nr. 24 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, diskutuan: Glauk Konjufca, Pal Lekaj, Valdete Bajrami, Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Slobodan Petroviq, Xhavit Haliti dhe Myfera Shinik, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e propozim-amendamentit nr. 24 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me shumicë votash (tre “për” dhe një “kundër”), vendosi që seanca tjetër plenare e Kuvendit të mbahet të premtën, më 29 maj 2015, me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i propozim-amendamentit nr. 24 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës

Gjithashtu, Kryesia lidhur me procedimin e propozim-amendamentit nr.24 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që për seancën plenare, më 29 maj 2015, në Kuvend ta procedojë Projektligjin për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencialë në proceset gjyqësore në Gjykatën Speciale.

Kryesia, pikën e propozuar të rendit të ditës - Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit të Posaçëm për zgjedhjen e dy (2) gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës e shtyu për shqyrtim për seancën plenare tjetër të radhës.

Kryetari i mbylli punimet e mbledhjes së Kryesisë në orën 12:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*